



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujevo – Municipality of Podujeva



KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Nr. 05/289

Podujevë,

10.06.2022

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në bazë të nenit 13 par 3 nen par 3.2 të Udhëzimit administrativ (MPMS) nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, pas shqyrtimit të ankesës nr. 05-615/03-0039638/22, e datës 31.05.2022, me datën 10.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa nr. 05-615/03-0039638/22 e datës 31.05.2022.

II.Shfuqizohet vendimi i Komisionit përzgjedhës nr. 05/266, i datës 30.05.2022, për zgjedhjen e kandidatëve për pozitën:Tutor/e.

Arsyetim

Më datën 31.05.2022 komisioni për shqyrtimin e ankesave ka pranuar ankesën nr. 05-615/03-0039638/22, kundër vendimit nr. 05/266, i datës 30.05.2022 të Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatit për pozitën Tutor/e, me arsyetimin se gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, komisioni përzgjedhës ka bërë shkelje procedurale.

Komisioni i ankesave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe administrimit të provave ka konstatuar se komisioni përzgjedhës ka shkelur dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik më saktësisht rreth afatit kohor të zhvillimit të procedurave të konkursit.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 13 par 3 nen par 3.2 të Udhëzimit administrativ (MPMS) nr.07/2017 , për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komisioni për shqyrtimin e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik – Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e marrjes së vendimit tek Inspektorati i punës.



Komisioni:

Sheribane Çitaku,

Adem Ajvazi,

Avni Maloku,